



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		16.08.2023	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	+060763	13178	

PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB)

IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

Komuna / Opština: <u>Drenas</u> Data / Datum: 19.04.2023
Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 2 <u>Takim i rregullt / Redovni sastanak</u> <input checked="" type="checkbox"/> <u>Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak</u> <input type="checkbox"/>
Numri i anëtarëve të KKSB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: <u>15</u>
A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSB-së? Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku? Po / Da <input type="checkbox"/> Jo / Ne <input checked="" type="checkbox"/> Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice <input type="checkbox"/>
A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSB-së? Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku? Po / Da <input checked="" type="checkbox"/> Jo / Ne <input type="checkbox"/> <i>Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë Monitorues nga KFOR LMT K-9 Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju</i>
A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari? Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik? Po / Da <input checked="" type="checkbox"/> Jo / Ne <input type="checkbox"/>

Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:

Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur me datë 01.02.2023: <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2023/02/Procesverbal-i-KKSBB-se.pdf>
2. Siguria në shkolla;
3. Të ndryshme

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Konkluzionet / Zaključci:

Konkluzionet e mbledhjes sipas rendit të ditës:

Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur me datë 01.02.2023: <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2023/02/Procesverbal-i-KKSBB-se.pdf>. Procesverbali u miratua unanimisht nga anëtarët e KKSBB-së. Pra, nuk pati ndonjë vërejtje.

Siguria në shkolla: Drejtori i DKA-së, Muhamet Gjoka informoi anëtarët e KKSBB-së për sigurinë e përgjithshme në shkollat e Drenasit. Ai theksoi se ditët e fundit ka pasur një tendencë të lehtë të rritjes së rasteve të dukurive negative, përkatësisht të dhunës në shkolla. Gjoka theksoi se kanë bashkëpunim të ngushtë me të gjithë akteret e sigurisë, dhe janë në përgatitje të Strategjisë për Sigurinë në Shkolla. “Kemi në vazhdim takime me drejtorë të shkollave, pedagog, organet e sigurisë dhe po bëjmë përpjekje në parandalimin e rasteve të dhunës në shkolla. Po ashtu, psikologu po mban ligjërata në vazhdimësi nëpër shkolla. Të martën, kemi pasur në takim edhe katër prokurore të Prokurorisë Themelore në Prishtinë ku kemi mbajtur ligjërata lidhur me disa tema të dukurive negative në shkolla”, ka thënë z.Gjoka. Ndërsa, zyrtari Policor i Stacionit Policor në Drenas, z.Florim Geci tha se siguria në shkolla është shqetësuese për të gjithë, po më shqetësuese duhet me qenë për prindërit të cilët janë faktori kryesor që mund të ndikojnë në sjelljet e nxënësve. Ai tregoi për takimet e përditshme lidhur me sigurinë në shkollat, ligjëratat çdo muaj me tema të ndryshme që sfidojnë sigurinë, rritjen e pikave të kontrollit dhe policëve civil për të siguruar që raste të dhunës të mos kenë në ambientet e shkollave. Poashtu, ai informoi se vetëm këtë vit kanë qenë 7 raste, pa përfshirë disa raste më të lehta që mbetën shënim zyrtar në stacion.

Edhe Arben Nika, nga EVSB theksoi se padyshim që prindërit janë një nga faktorët që mund të ndikojnë në parandalimin e rasteve dhe bashkëpunimin më të ngushtë me DKA-në, por që një nga format është mbështetja dhe rritja e aktiviteteve për të rinjtë. Edhe, Donika Zogu theksoi se kanë mungesë të një

hapësirë të përshtatshme për aktivitetet për të rinjtë, por që takimet i mbajnë qoftë në hapësira të shkollave apo komunës. Edhe përfaqësuesja nga Hendikos, znj.Lendita u shpreh se edhe drejtorët e shkollave në këtë drejtim kanë një rolë të rëndësishëm dhe se duhet të raportojnë çdo element që ka bazë dhunën. Skender Bogiqi theksoi se si KLSP mundohen të japin kontribut në këtë temë duke i trajtuar këto probleme edhe në mbledhjet e tyre, duke shprehur nevojën për zyre, ku nënkryetari z.Arben Shala theksoi se komuna ka problem me sigurimin e hapësirave por që janë duke shikuar të bëjnë zgjidhje në këtë drejtim.

- Forcimi i bashkëpunimit me prindërit dhe akterë të tjerë të nevojshëm;
- Mbështetja dhe rritja e aktiviteteve për të rinjtë për të parandaluar mundësinë e përfshirjes në dukuritë negative;
- Raportimi i çdo elementi që mund të dërgoj në dhunë mes nxënësve nga drejtorët e shkollave në DKA

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSb-së:

Izveštaj përpiluar nga Koordinator OOBZ: Laureta Thaqi

(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i publikuar)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Ramiz Lladrovci

Izveštaj odobrava Gradonačelnik:

Nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobranja: 17.04.2023

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSb-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSb-së.

Kopje: Anëtarëve të KKSb-së